



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

KUVENDI KOMUNAL PEJË

I. Numër: 400-01/29040, datë: 26 Prill 2024.

Në bazë të nenit 11, nenit 12. paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), dhe nenit 24. të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L – 049 për Financat e Pushtetit Lokal, Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me ligjin Nr. 05/L-007, Ligjit Nr. 08/L-260 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431, dt. 30 Shtator 2020, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 26 Prill 2024, në propozim të Drejtorisë për Buxhet e Financa dhe kryetarit të Komunës dhe në rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, merr:

VENDIM

Nr. 09/2024

Mbi tejkalimin e planit të hyrave vetanake për vitin 2023 dhe bartjen në vitin 2024

1. **MIRATOHET** tejkalimi i planit buxhetor i të hyrave vetanake për vitin 2023, në shumë prej: 1,007,040.75€ dhe bartja e tyre në dy programe buxhetore të kategorisë ekonomike të investimeve të vitit 2024, si vijon:

1.1. Drejtorinë për Punë Komunale dhe Shërbime Publike, në vlerë prej: 429,782.02 €

1.2. Drejtorinë për Kultur Rini dhe Sport, në vlerë prej: 577,258.73 €

2. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorin për Buxhet e Financa të Komunës së Pejës.

3. Pjesë e këtij vendimi është edhe shtojca 1: Tabelari i shtimit të buxhetit në programe buxhetore të vitit 2023.

3. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi ti dërgohet:
MAPL,
DFPT,
Kryetarit të Komunës,
DBF – ca,
Arkivë.

KRYESUESI I KUVENDIT
Rexhep Kurtbogaj

Shtojca 1: Tabelari i shtimit të buxhetit në programe buxhetore të vitit 2023



Kodi Funkcional	Kodi I nënprogramit	Kodi i Projektit	Emri i Projektit	SHUMA
635				1,007,040.75
180	Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia			429,782.02
18019	Infrastruktura Rrugore - Peje			429,782.02
,0451	18019	54629	Ndertimi i Sheshit Hotel Korze - Ura e zallit	429,782.02
850	Kulturë, Rinë, Sport			577,258.73
85019	Shërbimet Kulturore - Peje			577,258.73
,0820	85019	49924	Ndërtimi i Fushës së Futbollit në Fshatin Baran	165,812.38
,0820	85019	46455	Renovimi i Muzeut dhe Teatrit	111,446.35
,0820	85019	53046	Ndërtimi i palestres në Zahaq	300,000.00
TOTALI				1,007,040.75